



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 2

Tiranë – E hënë, 9 janar 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 82, datë 4.1.2023	Për shitje me ankand të pronës shtetërore në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara..... 3
Kërkesë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 1, datë 6.1.2023	Për ofertë, në kuadër të projektit “Përmirësimi i sistemit të shëndetësisë” – Ftesë për kuotim (ITQ) – Blerje për mallra: Pajisje IT për stafin e PCU- së, përfitues i së cilës është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale..... 4
Njoftim i Kryeministrisë nr. 110, datë 9.1.2023	Për rishpallje për kandidim për për zgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Statistikave..... 6



NJOFTIM
Nr. 82, datë 4.1.2023

**PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS
SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË
AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË
PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE
TË KONFISKUARA**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 888, datë 11.11.2020, “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”, shpallet për shitje me çmim fillestar, si më poshtë:

1. Në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lek)		Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Njësi			Data	Ora	Vendi
1	Garazh	Linzë, Tiranë	600 000	600 000	31		24.1.2023	10:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin, si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit apo të ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare në origjinal, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit në lek, për llogari të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

3. Deklarimin personal të secilit pjesëmarrës, që vërteton se ky i fundit nuk është në konflikt interesi, sipas dispozitave të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 34/2019, të ndryshuar.

4. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyruesisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pasi të keni tërhequr pranë kësaj agjencie faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave: www.financa.gov.al.

**KËRKESË**

Nr. 1, datë 6.1.2023

**PËR OFERTË, NË KUADËR TË
PROJEKTIT “PËRMIRËSIMI I SISTEMIT
TË SHËNDETËSISË” – FTESË PËR
KUOTIM (ITQ) – BLERJE PËR MALLRA:
PAJISJE IT PËR STAFIN E PCU-së,
PËRFITUES I SË CILËS ËSHTË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE**

9 janar 2023

Ftesë për kuotim (ITQ) – Blerje për mallra

Titulli i projektit: Projekti për përmirësimin e sistemit shëndetësor (HSIP)

Kontrata: Pajisjet IT për stafin e PCU-së, sipas projektit HSIP HSIP/G/SH/02-2020

I nderuar furnizues,

1. Jeni të ftuar të paraqisni kuotimin/et e çmimeve për artikujt e mëposhtëm:

Nr.	Emri i pajisjes	Njësia	Sasia
1	Kompiuter Workstation (sipas prodhuesit) – Computer Workstation	copë	7
2	UPS	copë	7
3	Skaner Tip 4/Scanner type 4	copë	1
4	FOTOKOPJE Multifunction Color MFP Basic/Multifunction photocopy	copë	1
5	Printer Color Advanced	copë	1
6	Laptop Advanced	copë	3

Kuotimet duhet të mbulojnë të gjithë artikujt e kërkuar, si dhe të gjitha sasi të kërkuara për atë artikull (kuotimet e pjeshme nuk do të pranohen).

Informacioni mbi specifikimet teknike, sasi të kërkuara dhe orari i dorëzimit gjenden në www.shendetesia.gov.al ose mund të jepet duke dërguar me kërkesë me shkrim në adresën hsip.dudushi@gmail.com.

2. Kuotimi juaj i çmimit në formularin e bashkangjitur mund të dorëzohet personalisht ose me postë në adresën e mëposhtme:

Znj. Entela Ramosaçaj

Zëvendësministër

Projekti për Përmirësimin e Sistemit Shëndetësor

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Rruga e Kavajës) Tiranë, Shqipëri.

3. Afati i fundit për marrjen e kuotimit/eve tuaj/a nga blerësi, në adresën e treguar në këtë paragraf: **23 janar 2023, ora 11:00, me orën lokale.**

4. Kuotimi juaj në dy kopje dhe në gjuhën angleze duhet të shoqërohet me dokumentacion

teknik dhe katalog/ët adekuat/ë dhe materiale të tjera të shtypura ose informacione përkatëse për artikullin e cituar, duke përfshirë emrat dhe adresat e firmave, që ofrojnë, gjithashtu, mirëmbajtjen e *software-it* në Shqipëri.

5. Kuotat tuaja duhet të dorëzohen sipas udhëzimeve të mëposhtme dhe në përputhje me kontratën e bashkangjitur. Termat dhe kushtet e furnizimit të bashkangjitur janë pjesë përbërëse e kontratës.

i. Çmimet: çmimet duhet të kuotohen në euro (EUR) për koston totale që përfshin të gjitha taksat, TVSH-në, detyrimet, instalimin.

ii. Gjithashtu, duhet të plotësohen të gjitha specifikimet teknike.

ii. Vlerësimi i kuotimit: ofertat e përcaktuara se janë në thelb të përgjegjshme ndaj specifikimeve teknike do të vlerësohen duke krahasuar çmimin total në destinacionin përfundimtar sipas paragrafit “i” më lart.

Në vlerësimin e kuotimeve, blerësi do të përcaktojë për çdo ofertë çmimin e vlerësuar, duke rregulluar kuotimin e çmimit, duke bërë ndonjë korrigjim për çdo gabim aritmetik, si më poshtë:

a) kur ka një mospërputhje midis shumave në shifra dhe me fjalë, shuma me fjalë do ta rregullojë;

b) kur ka një mospërputhje ndërmjet normës së njësisë dhe totalit të zërit, që rezulton nga shumëzimi i normës së njësisë me sasinë, norma për njësi e kuotuar do ta rregullojë;

c) nëse një furnizues refuzon të pranojë korrigjimin, kuotimi i tij do të refuzohet.

iii. Dhënia e urdhrit të blerjes: dhënia do t’i jepet ofertuesit që ofron çmimin më të ulët të vlerësuar dhe që plotëson standardet e kërkuara të aftësive teknike dhe financiare. Ofertuesi i suksesshëm do të nënshkruajë një kontratë, sipas formës së bashkangjitur të kontratës dhe kushteve të furnizimit.

iv. Vlefshmëria e ofertës: kuotimi/et juaj/tuaja duhet të jetë/jenë i/të vlefshëm/me për një periudhë prej 45 (dyzet e pesë) ditësh nga afati i fundit për marrjen e kuotimeve të treguara në paragrafin 5 të kësaj ftese për kuotim.

7. Informacione të mëtejshme mund të merren nga:

Znj. Blerina Dudushi

Menaxher i projektit

Projekti për Përmirësimin e Sistemit Shëndetësor

hsip.dudushi@gmail.com



Teksti i plotë i ITQ-së (ftesës për ofertë) përfshirë dhe specifikimet teknike gjendet në www.shendetesia.gov.al ose mund të jepen duke dërguar me kërkesë me shkrim në adresën hsip.dudushi@gmail.com.

9th of January 2023

Invitation to Quote (ITQ) – Shopping For Goods

Project Title: Health System Improvement Project (HSIP)

Contract: “It equipment for PCU staff under HSIP project” HSIP/G/SH/02-2020

Dear Supplier,

1. You are invited to submit your price quotation(s) for the following items:

Nr.	Name	Njësia	Amount
1	Komputer Workstation (sipas prodhuesit) - Computer Workstation	copë	7
2	UPS	copë	7
3	Skaner Tip 4/Scanner type 4	copë	1
4	Fotokopje Multifunction Color MFP Basic/Multifunction photocopy	copë	1
5	Printer Color Advanced	copë	1
6	Laptop Advanced	copë	3

The quotations should cover all required items, as well as all quantities required for that item (partial quotations will not be accepted).

Information on Technical Specifications, required quantities and delivery schedule are available at www.shendetesia.gov.al or may be provided upon request in writing to hsip.dudushi@gmail.com

2. Your price quotation in the form attached may be submitted in person or by mail at the following address:

Mrs. Entela Ramosaçaj

Deputy Minister

Health System Improvement Project

Ministry of health and Social protection (Rruga e Kavajës) Tirana, Albania.

3. The deadline for receipt of your quotation (s) by the Purchaser at the addressed indicated in this paragraph: **23th of January 2023 11:00 local time.**

4. Your quotation in duplicate and in English language, should be accompanied by adequate technical documentation and catalogue(s) and other printed material or pertinent information for the item quoted, including names and addresses of firms providing also software maintenance in Albania.

5. Your quotation(s) should be submitted as per the following instructions and in accordance with the attached Contract. The attached Terms and Conditions of Supply is an integral part of the Contract.

i) **PRICES:** The prices should be quoted in Euro (**EUR**) for the Total Cost which includes all taxes, VAT, duties, installation.

ii) In addition all the technical specifications must be fulfilled.

ii) **EVALUATION OF QUOTATIONS:** Offers determined to be substantially responsive to the technical specifications will be evaluated by comparison of the total price at final destination as per paragraph (i) above.

In evaluating the quotations, the Purchaser will determine for each bid the evaluated price by adjusting the price quotation by making any correction for any arithmetical errors as follows:

a) Where there is a discrepancy between amounts in figures and in words, the amount in words will govern;

b) Where is a discrepancy between the unit rate and the line item total resulting from multiplying the unit rate by the quantity, the unit rate as quoted will govern;

c) If a Supplier refuses to accept the correction, his quotation will be rejected.

iii) **AWARD OF PURCHASE ORDER:** The award will be made to the bidder offering the lowest evaluated price and that meets the required standards of technical and financial capabilities. The successful bidder will sign a Contract as per attached form of contract and terms and conditions of supply.

iv) **VALIDITY OF THE OFFER:** Your quotation(s) should be valid for a period of forty five (45) days from the deadline for receipt of quotation(s) indicated in Paragraph 5 of this Invitation to Quote.

7. Further information can be obtained from:

Mrs. Blerina Dudushi

Project Manager

Health System Improvement Project

hsip.dudushi@gmail.com

The complete text of ITQ (Invitation to quote) including technical specifications is available at www.shendetesia.gov.al or may be provided upon request in writing to hsip.dudushi@gmail.com.



NJOFTIM

Nr. 110, datë 9.1.2023

**PËR RISHPALLJE PËR KANDIDIM PËR
PËRZGJEDHJEN E KANDIDATËVE PËR
ANËTARË TË KËSHILLIT TË
STATISTIKAVE**

Në mbështetje të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikën zyrtare”, dhe të pikës 2, të vendimit nr. 670, datë 7.11.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, të përfaqësimit, emërimit e shkarkimit, rregullat e funksionimit dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Statistikave”, shpallim njoftimin për kandidim për anëtarë të Këshillit të Statistikave.

Konkurrimi është i hapur për përfaqësues që u përkasin **përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare, botës akademike, shoqërisë civile dhe medias.**

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët për anëtarë të Këshillit të Statistikave, që propozohen nga Këshilli i Ministrave, janë, si më poshtë vijon:

Kandidatët për anëtarë, përfaqësues të përdoruesve kryesorë të statistikave zyrtare:

i. Të jenë nga radhët e nëpunësve civilë të Kryeministrit, të cilët merren, kryesisht, me hartimin e strategjive zhvillimore dhe monitorimin e zbatimit të tyre;

ii. Të jenë nëpunës civilë, të paktën të nivelit të mesëm drejtues;

iii. Të kenë lidhje me përdorimin e të dhënave statistikore në natyrën e punës së tyre;

iv. Të kenë jo më pak se 3 (tre) vjet përvojë pune në përdorimin e statistikave.

Kandidati për anëtar, përfaqësues i botës akademike:

i. Të jetë nga radhët e personelit akademik, i punësuar me kohë të plotë, në institucione të arsimit të lartë, publik ose privat, të licencuar e të akredituar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë;

ii. Të ketë përvojë në punë jo më pak se 10 (dhjetë) vjet në fushën e statistikave ose të ekonomisë apo të shkencave të natyrës;

iii. Të zotërojnë tituj akademikë.

Kandidati për anëtar, përfaqësues i shoqërisë civile:

i. Të jetë nga radhët e organizatave jofitimprurëse, që përdorin tregues statistikore për kryerjen e veprimtarisë së tyre;

ii. Të jetë i punësuar në organizatë për jo më pak se 3 (tre) vjet;

iii. Të jetë i angazhuar në përdorimin e statistikave në fushat e ekonomisë, të shkencave të natyrës apo të shkencave sociale.

Kandidati për anëtar, përfaqësues i medias:

i. Të jetë nga radhët e medias kombëtare;

ii. Të jetë i punësuar me kohë të plotë;

iii. Të ketë përvojë në punë jo më pak se 10 (dhjetë) vjet në fushën e gazetarisë ekonomike.

Kriteret të përgjithshme:

a) Të jetë shtetas shqiptar;

b) Të jetë person i padënuar apo ndaj të cilit nuk janë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar.

Shënim. Kandidatët për anëtarë në Këshillin e Statistikave duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë dokumentacionin që provon plotësimin e kriterëve sipas kategorive përkatëse.

Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve punë nga data e njoftimit, organizatat e shoqërisë civile duhet të paraqesin kandidatët përkatës, së bashku me dokumentet e nevojshme, përfshirë:

- Kërkesën për aplikim;

- Curriculum Vitae CV;

- Referencat dhe letrat mbështetëse nga 5 organizata jofitimprurëse;

- Dokumente dhe deklarata të tjera provuese për vërtetimin e përmbushjes së kriterëve të kandidimit, si më lart.

Afati i dorëzimit të aplikimit është deri më 30.1.2023, dhe të dorëzohet në adresën e Kryeministrit. Kandidatët e kualifikuar do të njoftohen nëpërmjet *e-mail*-it.

Adresa: Kryeministria

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 1, 1000

Tiranë, Shqipëri

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm

Tel: 04 22 77 401

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Tiranë, 2023